

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

MBLEDHJE BORDI

VENDIME

Gjatë muajit nëntor Bordi i ERE-s ka zhvilluar 4 mbledhje, të cilat kanë rezultuar në 36 vendimmarrje, ndër të cilat tre vendime mbi ndryshime në kushtet e licensimit nga ana e subjekteve të licencuara me heret nga ERE; pezullimin e zbatimit të kërkesave të neneve 4.1, 8 dhe nenit 10 të "Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të originës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019 deri në miratimin nga ERE dhe hyrjen në fuqi të Rregullores së re për dhënien, transferimin apo anulimin e GO-ve, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 24/2023; një dhënie autorizimi për vendosjen e kuotave të subjektit të licencuar, si mjet (barrë sigueruese) për garantimin e përmbushjeve të detyrimeve ndaj palës huadhënëse; si dhe fillimin e dy procedurave përkatësisht një për trajtim të mosmarrëveshjes lindur mes të katër subjekteve dhe FTL sh.a. mbi prodhimin e lëvruar dhe të pakontraktuar, nga njësitë gjeneruese fotovoltaike në zotërim të këtyre subjekteve, për periudhën 28.07.2022 – 08.11.2022; si dhe një kërkesë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Mireshi", në qarkun Dibër, me kapacitet total 1.900 MW; si dhe përcaktimi i çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Tetor 2023 prej 16.13 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Gjithashtu, ndër vendimmarrje të tjera të marra gjatë këtij muaji përmendim:

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë "KESH" sh.a. për dhënien e Garancisë së Originës për periudhën 01.10.2022 - 30.09.2023, për energjinë elektrike të prodhuar nga:

- Hec "Fierzë" - 1,779,095 MWh
- Hec "Koman" - 2,264,089 MWh
- Hec "Vau i Dejës" - 1,134,560 MWh

Garancia e Originës (GO), është një dokument elektronik, i cili ka funksion të vetëm që t'i provojë konsumatorit fundor se, një pjesë ose e gjithë sasia e energjisë elektrike të përdorur prej tij është prodhuar prej burimeve të rinovueshme.

2. Shfuqizimin e pikave 2 dhe 3 në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 228, datë 17.07.2023, "Mbi përcaktimin e shoqërisë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX" sh.a., si operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike (NEMO)", si rezultat i përmbushjes së kushteve të vendosura në vendim.

3. Miratimin e Draft "Memorandumit të mirëkuptimit për bashkimin e tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike në Europën Jug - Lindore, i cili synon bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe të Kosovës për të krijuar kushtet për integrimin e tregjeve kombëtare të energjisë elektrike me shumicë në një nivel të ditës në avancë si dhe zbatimin e Modelit të Synuar të BE-së për alokimin implicit të kapaciteteve, duke përdorur zgjidhjet dhe praktikatat më të mira ekzistuese ndër-europiane.

4. Shfuqizimi i vendimit mbi kërkesën e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar, si reflektim i Vendimit nr. 54 të Gjykatës Administrative të Apelit.

ERE gjithashtu, ka nisur gjatë muajit nëntor, procedurën për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2023 të pashlyera ndaj ERE-s.

Për tu bërë me dije mbi subjektet përkatëse, por dhe vendimet e sipërcituara, ju lutemi të vizitoni faqen tonë zyrtare www.ere.gov.al.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE

Në datën 07.11.2023 në ambjentet e ERE, Kryetari i ERE z.Petrit Ahmeti si dhe Bordi i ERE, mirëpritën Kryetarin dhe Bordin e rregullatorit të Kosovës. Temat e diskutimit u fokusuan ndër të tjera në harmonizimin e bashkëveprimeve ndërmjet dy rregullatorëve për metodologjinë e tarifës së NEMO-s si dhe lidhur me çështje të tjera të cilat lidhen me bashkëpunimin e dy rregullatorëve.

Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e të dy rregullatorëve patën gjithashtu diskutime mbi bashkërendimin e punëve lidhur me operimin e tregut të përbashkët të Ditës në Avancë. Ky takim i Bordeve të të dy rregullatorëve, çon përpara procesin e bashkimit të tregjeve Shqipëri-Kosovë, duke vendosur fokusin në rëndësinë që ky bashkëpunim ka jo vetëm për tregjet përkatëse të energjisë elektrike por edhe për zhvillimet e mëtejshme të tregjeve në rajon e më gjërë.



SEANCA DËGJIMORE

Gjatë muajit nëntor, pjesë e aktivitetit të ERE-s kanë qënë dhe seancat dëgjimore me konsumatorë, subjektet si dhe palë interesi, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo përfundimin e qëndrimeve të palëve me qëllim një vendimmarrje më të plotë.

Ndër to mund të përmendim 6 (gjashtë) seanca dëgjimore të zhvilluara nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, mbi ankesat e ardhura në ERE nga konsumatorë të ndryshëm, mbi të cilat u trajtuan në bashkëpunim me FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a.; 3 (tre) seanca dëgjimore të zhvilluara nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me subjekte të licencuara dhe palë të përfshira në proces, të cilat në thelb kanë patur evidencime dhe sqarime të nevojshme për të çuar para procese si rinovim të licencës apo kërkesa të ndryshme, në zbatim të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.

Për tu përmendur vlen dhe takimi i zhvilluar mes Drejtorisë së Monitorimit dhe Inspektimit dhe përfaqësuesve të shoqërive: (i) Tren Sun System sh.p.k., (ii) Sun Beat System sh.p.k., (iii) NTSP sh.p.k., (iv) Korca Photovoltaic park sh.p.k., shoqërisë OSSH sh.a. dhe OST sh.a., në lidhje me mosmarrëveshjen me këtë të fundit, për të cilën ERE ka filluar procedurën dhe pritet të marrë një vendim gjatë muajit dhjetor.

NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE

Ditën e hënë, datë 13.11.2023 u mbajt takimi i tretë i grupit të punës për Qëndrueshmërinë e Prodhimit të Energjisë së Gjelbër në Ballkanin Perëndimor në kuadër të projektit të financuar nga CIPE (Centre for International Private Enterprise). Në këtë takim të pranishëm ishin përfaqësues të kompanive që operojnë në këtë fushë, përfaqësues nga Enti Rregullator i Energjisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe nga ProCredit Bank.



Më datë 14.11.2023 në Athinë u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkimin e tregjeve të një dite më parë midis Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë nën suportin e USAID pjesë e iniciativës të Bashkimit të tregjeve të Vendeve të Evropës Juglindore. Memorandumi u nënshkrua nga Rregullatorët, operatorët e transmetimit si dhe bursat e energjisë elektrike të katër vendeve dhe ka për qëllim ndër të tjera nevojën e bashkëpunimit për të mundësuar harmonizimin e mekanizmave të integruar për menaxhimin e flukseve të energjisë në rajon nëpërmjet integritimit të tregjeve të një dite më parë, implementimit të Modelit Evropian të alokimit të kapaciteteve si dhe pjesëmarrjes në organizatat ekzistuese apo dhe grupeve të punës. Gjatë fjalës së tij, Kryetari i ERE-s, Z. Ahmeti theksoi rëndësinë e nënshkrimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi i cili është vazhdim i angazhimeve të ndërmarra prej nënshkrimit të Traktatit të Energjisë në 2005 si dhe një gur themeli në integrimin e tregjeve elektrike të vendeve të Evropës Juglindore me vendet e BE-së, i cili do të shërbejë mirëqënies sociale të vendeve tona.



NEWSLETTER

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

AKTIVITETE

Shoqata Rajonale e Rregullatorëve të Energjisë (ERRA), organizatë në të cilën Enti Rregullator i Energjisë është anëtare themeluese që prej vitit 2000, organizoi më 24 dhe 25 Nëntor 2023 në Stamboll takim vjetor të kryetarëve të Enteve Anëtare, me mikëpritje të Entit Rregullator të Turqisë. Në këtë aktivitet Enti Rregullator i Energjisë u përfaqësua nga Kryetari Z. Petrit Ahmeti dhe Sekretari i Përgjithshëm Z. Elton B. Radheshi.

Sekretariati ofroi informacion në lidhje me aktivitetet prioritare të ERRA dhe kalendarin e ngjarjeve. Gjatë aktivitetit u diskutua ndër të tjera mbi formën e re të sistemeve energjetike, rrugët klimatike të tregjeve në zhvillim dhe ato kufitare, sigurinë energjetike në tranzicion energjetik, të ardhmen e gazit natyror dhe bërthamor, perspektivën për kërkesën për energji dhe shumë të tjera.



Më 16 Nëntor 2023, u organizua në Lubjanë, Slloveni, Konferenca e Sekretariatit të Energjisë mbi Avancimin e Investimeve të Rinovueshme, nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë së Vienës.

Konferenca shërbeu si një mbledhje e veçantë, duke sjellë së bashku një gamë të gjerë pjesëmarrësish, duke përfshirë ministrinë e energjisë, rregullatorët e energjisë, operatorët e sistemit të shpërndarjes (OSSH), operatorët e sistemit të transmetimit (OST), drejtorët dhe anëtarët e bordit të organizatave përgjegjëse për garancitë e origjinës, Palët Kontraktuese (P), investitorë të energjisë së rinovueshme, entitete korporative, institucione financiare, organizata të nderuara ndërkombëtare dhe të tjera të ndryshme.

Kjo asamble gjithëpërfshirëse e palëve të interesuara u thellua në tendencat më të fundit dhe më largpamëse, qasjet strategjike dhe mundësitë premtuese në fushën e energjisë së rinovueshme. ERE u përfaqësua në këtë konferencë nga Sekretari i Përgjithshëm Z. Elton B. Radheshi.

Seminari i 4-rt i organizuar nga Shkolla Ballkanike e Energjisë (BES) me titull 'Si të krijohen projektet e zbatimit lokal të bashkimit të tregut' u zhvillua pranë zyrave të ARERA në datë 30 Nëntor 2023. Në kuadër të projektit të KEP për mbështetjen e Autoritetit Rregullator Shqiptar për të përmirësuar efikasitetin e tregut me shumicë të energjisë". Ky takim u hap nga Z.Stefano Saglia Kryetar i BES, Z.Andrea Cascone (Drejtori i Ballkanit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Italisë) dhe Z.Elton B. Radheshi, Sekretar i Përgjithshëm i ERE.

Ndër të tjera në takim u diskutua mbi bashkimin e tregut midis Shteteve Anëtare të BE-së dhe Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, mbi ngritjen e projekteve të zbatimit lokal të bashkimit të tregut, mbi përcaktimin e procedurave lokale dhe kuadri kontraktual për NEMO.

Në këtë seminar ERE u përfaqësua gjithashtu dhe nga Z. Denis Rushaj, Drejtor i Drejtorisë Juridike, Z. Lorenc Kosta, Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit të Tregut si dhe Z. Elvis Himci, Specialist i Drejtorisë së Tarfave dhe Çmimive.